

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **613-26-1500-5-2-1**

Sa i përket tenderit për: **Renovimi i objektit të shkollës Vëllezërit Frashëri në Lipjan.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NOI CONSTRUCTION SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga Haxhi Kleqka Lipjan.

(Adresa)

Lipjan

14000

(Vendi)

(Kodi postar)

045785649

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Labinot Dedushi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Noiconstruction.shpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

18.06.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

1. Njoftimi per kontrate 23.05.2026
2. Procesverbali i Hapjes se ofertave 27.04.2026
3. Njoftim mbi Vendimin e AK-se 05.06.2026
4. Kerkese per Rishqyrtim me daten 10.06.2026
5. Njoftimi mbi vendimin e Kerkeses per Rishqyrtim 15.06.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Procesi I hapjes se ofertave ka shkuar përmesë platëformës elektronike e-prokurimi!

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- **Ligji me nr. 04/L-042, për Prokurim Publik i amendamentuar –**
- **Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi –**
- **Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes –**
- **Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënie të kontratës –**
- **Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve –**
- **Neni 61 Tenderët Jo-normalisht të Ulët –**
- **Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit –**
- **Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarreveshjeve Rregullorja me nr. 001/2022, për Prokurim Publik. –**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përkrahuesi rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

NOI CONSTRUCTION SHPK ushtron të drejtën e saj ligjore që përmes kësaj ankese të drejtuar Panelit të Organit shqyrtues të prokurimit, të argumentuar me prova dhe të bazuar në dispozitat përkatëse ligjore, ta ankimoj vendimin e shpallur nga Autoriteti Kontraktues- Kuvendi Komunal Lipjan vendim I cili është në kundërshtim me dispozitat ligjore konkretisht ligjit te prokurimit publike ne Kosove.

Sipas Ligjit per prokurim Publik Te Republikës së Kosovës nr 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/ L-092, ne kemi bere kerkesa per rishqyrtim me daten 10.06.2026 ku kerkesa jone eshte **APROVUAR SI PJESERISHT E BAZUAR**.

Përveç shkeljeve të lartcekura, Vendimi i Autoritetit Kontraktues është i mangët edhe për faktin se kërkesa për rishqyrtim është **aprovuar si "pjesërisht e bazuar"**, pa specifikuar qartë se cilat pretendime janë konsideruar të bazuara dhe cilat pretendime janë refuzuar.

Në dispozitivin e vendimit, Autoriteti Kontraktues është mjaftuar vetëm me konstatimin se kërkesa për rishqyrtim aprovohet pjesërisht dhe lënda kthehet në rivlerësim, pa identifikuar në mënyrë të qartë dhe konkrete pretendimet e pranuar. Një mënyrë e tillë e vendosjes e bën vendimin të paqartë sepse ne kemi bere ankese per disa operatore ekonomik te cilat kane pretendime dhe mangesi te njejta te dosjes se tenderit.

Si eshte e mundur marrveshja e konzerciumit e cila nuk plotesen kerkesat e dosjes se tenderit e grupit te OE 3A Projekt SH.P.K.; EURO CONSTRUCTION NNP SH.P.K te aprovohet pjeserisht e bazuar ndersa per NNP CTA SHPK te konsiderohet gabim Teknik.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë dhe vlerësimit të njëjtë të ofertave, pasi për të njëjtën mangësi në Marrëveshjen e Konsorciumit ka nxjerrë dy përfundime të ndryshme.

Nga vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim I cili eshte pjeserisht I bazuar rezulton se AK ka konstatuar se mungesa e përcaktimit të liderit të grupit në Marrëveshjen e Konsorciumit për operation ekonomik 3A Projekt SH.P.K.; EURO CONSTRUCTION NNP SH.P.K përbën mangësi që ndikon në vlefshmërinë e ofertës, ndërsa për operatorin ekonomik NNP CTA SHPK, ndonëse ekziston e njëjta mangësi faktike dhe juridike, AK e ka **cilësuar atë si "gabim teknik" dhe e ka konsideruar ofertën të përgjegjshme.**

Një qasje e tillë paraqet standard të dyfishtë në vlerësimin e ofertave dhe cenon parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë. Nuk mund të ekzistojnë dy interpretime të ndryshme për të njëjtën dispozitë dhe të njëjtën mangësi dokumentare.

Nëse mungesa e përcaktimit të liderit të grupit konsiderohet mangësi materiale për operatori ekonomik 3A Projekt SH.P.K.; EURO CONSTRUCTION NNP SH.P.K, atëherë e njëjta duhet të ketë të njëjtin efekt juridik edhe për operatorin tjetër NNP CTA SHPK që ndodhet në situatë identike.

Ne vazhdim po I elaborojm pretendimet tona per Grupin e Operatoreve ekonomik 3A Projekt SH.P.K.; EURO CONSTRUCTION NNP SH.P.K, ku keto pretendime tona **jane te aprovuar si pjeserisht te bazuar**

Pretendimi 1:

Grupi i Operatoreve ekonomik 3A Projekt SH.P.K.; EURO CONSTRUCTION NNP SH.P.K i rekomanduar per kontrate nuk ploteson kerkesat minimale te dosjes se tenderit

Marrëveshja e Konsorciumit nuk i përmbush kërkesat e dosjes së tenderit dhe formularit standard të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues, pasi në të mungon elementi thelbësor që përcakton përgjegjësitë e secilit anëtar të grupit të operatorëve ekonomikë.

Shiko se ne dosje te tenderit ANEKSI 8 DEKLARATA PER THEMELIM TE GRUPIT

SE CFAR ESHTË KERKUAR NE DOSJE TE TENDERIT :

- Në bazë të nenit 26.15, të ndryshim plotësimit të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Operatorët Ekonomik që marrin pjesë si grup, së bashku me ofertën e tyre duhet të ofrojnë një **Marrëveshje (deklaratë) për themelimin e grupit**, në të cilën anëtarët e grupit do t'i përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë, si dhe të gjitha veprimet procedurale që duhet t'i kryej lideri i grupit në emër të grupit.

Plotësimi i Marrëveshjes (deklaratës) për themelimin e grupit, i vendosur në Aneksin 8 është obligative për Operatorët Ekonomik që marrin pjesë si grup.

h. **Ne të gjithë anëtarët e grupit** konfirmojmë se **jemi të përshtatshëm** dhe do të sigurojmë dëshminë mbi përshtatshmërinë, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të FDT-së.

i. **Ne të gjithë anëtarët e grupit** konfirmojmë pjesëmarrjen tonë në grup dhe deklarojmë se % (përqindjen) e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës është:

a) [Shëno % (përqindjen) e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës së Liderit]

b) [Shëno % (përqindjen) e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës së anëtarit]

Shto sipas nevojës

j. **Ne të gjithë anëtarët e grupit** konfirmojmë përgjegjësitë e secilit anëtar:

a) [Shëno përgjegjësitë e Liderit]

b) [Shëno përgjegjësitë e anëtarit]

Shto sipas nevojës

k. **Ne të gjithë anëtarët e grupit** konfirmojmë se në rast të shfrytëzimit të drejtës për ankesë si parashihet në nenet 108A dhe 109 të LPP-së, të drejtën për të dorëzuar kërkesën për rishqyrtim/ankesën e ka vetëm lideri i grupit të OE.

Shiko se cfare ka prezantuar Grup te Operatoreve ekonomik 3A Projekt SH.P.K.; EURO CONSTRUCTION NNP SH.P.K

Anëtarët e grupit lidhim këtë marrëveshje me të cilën deklarojmë:

- e. **Ne të gjithë anëtarët e grupit jemi bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës.**
- f. **Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë pjesëmarrjen tonë në grup dhe se nuk jemi duke marrë pjesë në mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;**
- g. **Ne të gjithë anëtarët e grupit e autorizojmë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe ai është: 3A Projekt SH.P.K. & EURO Construction NNP SHPK**
- h. **Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë se jemi të përshtatshëm dhe do të sigurojmë dëshminë mbi përshtatshmërinë, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të FDT-së.**
- i. **Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë pjesëmarrjen tonë në grup dhe deklarojmë se % (përqindjen) e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës është:**
- a) 60 % e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës se *Liderit*
 - b) 40 % e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës e *anëtarit*
- j. **Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë se në rast të shfrytëzimit të drejtës për ankesë si parashihet në nenet 108A dhe 109 të LPP-së, të drejtën për të dorëzuar kërkesën për rishqyrtim/vankesën e ka vetëm lideri i grupit të OE.**
- k. **Ne të gjithë anëtarët e grupit pranojmë që: nëse një anëtar i grupit tërhiqet pas dorëzimit të tenderit (gjatë fazës së vlerësimit), Autoriteti Kontraktues të vazhdoj me anëtarin e mbetur, nëse anëtari i mbetur i plotëson kushtet e parapara në Dosje të Tenderit. Po ashtu ne pranojmë që në këtë rast ndaj anëtarit i cili tërhiqet nga grupi, Autoriteti Kontraktues të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-së.**

P.K.

EURO
CONSTRUCTION
NNP

SH.P.K.

Konkretisht, në marrëveshje te konzerciumit MUNGON kjo pike nuk janë të specifikuara përgjegjësitë dhe obligimet që do të realizohen nga **lideri i grupit** dhe nga anëtarët e tjerë të konsorciumit, përkundër faktit se kjo kërkesë është paraparë shprehimisht në formularin e marrëveshjes së konsorciumit.

Mungesa e këtij informacioni e bën të pamundur identifikimin e rolit, pjesëmarrjes dhe përgjegjësiwe kontraktuale të secilit anëtar në ekzekutimin e kontratës.

Kjo mungesë nuk paraqet një lëshim formal apo teknik që mund të korrigjohet por paraqet mungesë të një elementi esencial të marrëveshjes së konsorciumit, i cili është dashur të ekzistojë dhe të jetë pjesë e ofertës në momentin e dorëzimit të saj.

Për rrjedhojë, oferta e operatorit ekonomik nuk është në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe si e tillë është dashur të shpallet e papërgjegjshme, ndërsa pranimi i saj nga Autoriteti Kontraktues paraqet shkelje të parimit të trajtimit të barabartë dhe të kërkesave të dokumentacionit të tenderit, konkretisht Nenit 59 te LPP-se. Ne marrveshje te konzerciumit mungon kjo pike ku paraqiten pergjegjesis, nenkupton qe marrveshja e konzerciumit eshte e manget.

Poashtu kemi edhe udhezimin administrative **10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve**, ku jep udhezimin se duhet te refuzohet menjehere tenderi.

Mungon deklarata e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
Mungon deklarata e nënshkruar nga secili anëtar për konfirmim të pjesëmarrjes	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ

Pretendimi 2.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe parimet themelore të prokurimit publik ku ka kërkuar përmes sqarimeve te nje pas njeshme te panevojshme dokumente që mungonin tërësisht në ofertë.

Sipas dokumentacionit të tenderit, operatorët ekonomikë 3A Projekt SH.P.K.; EURO CONSTRUCTION NNP SH.P.K kanë qenë të obliguar që në momentin e dorëzimit të ofertës të paraqesin **listën e stafit profesional** së bashku me dëshmitë përkatëse për secilin pozicion të kërkuar.

Nga shkresa për sqarim e datës **19.05.2026** vërehet qartë se ju si Autoritet Kontraktues keni konstatuar se operatori ekonomik nuk ka dorëzuar listën e stafit sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe se për një numër të konsiderueshëm të pozitave "**nuk keni ofruar asnjë dëshmi**".

Në këto rrethana nuk kemi të bëjmë me paqartësi, gabim teknik apo dokument të dorëzuar pjesërisht, **por me mungesë të plotë të dokumenteve** që kanë shërbyer për vërtetimin e kapacitetit teknik dhe profesional.

Përmes kërkesës për sqarim te njepasnjeshme,ju si Autoritet Kontraktues i keni mundësuar operatorit ekonomik që **pas afatit për dorëzimin e ofertave të plotësojë dokumentacionin thelbësor të ofertës**, dokumentacion i cili është dashur të ekzistojë dhe të jetë pjesë e ofertës në momentin e dorëzimit të saj.

Kërkimi i listës së stafit pas hapjes së ofertave përbën në fakt plotësim të ofertës dhe jo sqarim të saj.

Një veprim i tillë cenon parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe krijon **avantazh** të padrejtë për operatorin ekonomik të favorizuar, pasi i mundësohet që pas skadimit të afatit të ofertimit të dëshmojë kapacitete të cilat nuk i ka deklaruar dhe dokumentuar në ofertën fillestare.

Për rrjedhojë, oferta e operatorit ekonomik është dashur të **shpallet e papërgjegjshme** për shkak të mosplotësimit të kërkesës së kapacitetit teknik dhe profesional në momentin e ofertimit, ndërsa ju si Autoritetit Kontraktues për dorëzimin e listës së stafit dhe dëshmimeve përkatëse pas hapjes së ofertave **paraqet tejkalim të kufijve të lejuar të sqarimeve dhe shkelje të dispozitave të prokurimit public konkretisht Neni 59 Te LPP-se.**

Kjo tregon se dokumentet nuk kanë qenë fare në ofertë. Kur mungon dokumenti dhe dëshmia në tërësi, nuk kemi sqarim të ofertës, por plotësim të saj pas afatit të ofertimit dhe ju si AK ka qene dashur te eliminoni grupin e operatoreve ekonomik 3A Projekt SH.P.K.; EURO CONSTRUCTION NNP SH.P.K si te **PAPERGJEGJSHEM.**

Pretendimi 3.

Ne dosje te tenderit eshte kerkuar k) **Dumper vet shkarkues ne 3 anet max 5 ton.**

Grupi I operatorëve ekonomikë 3A Projekt SH.P.K.; EURO CONSTRUCTION NNP SH.P.K te cilen jane te pa pergjegjshem kane prezantuar nje libreze te nje DUMPERI I cili nuk ploteson kerkesen e dosjes se tenderit sepse Dumperi I prezantuar ka peshe 10210 kg, andaj ju si AK ne kete rast ka qene dasht te beni eliminimin e Grupit te OE te papergjegjshem dhe jo te shpallet fitues, **ne kerkojme qe ky pretendim te merret I bazuar.**

(Shiko Librezen ne dokumentat e OE).

Pretendimi 4

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Grupi I operatorëve ekonomikë 3A Projekt SH.P.K.; EURO CONSTRUCTION NNP SH.P.K, konstatohet se deklarata nën betim nuk i plotëson kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe/ose legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Për shkak të mangësive të identifikuara, deklarata nuk mund të konsiderohet e rregullt dhe e vlefshme për të dëshmuar përmbushjen e kërkesave të kërkuara në këtë procedurë të prokurimit.

Si rrjedhojë, kërkohet që dokumenti në fjalë të vlerësohet si i papranueshëm dhe oferta të trajtohet në përputhje me dispozitat e dosjes së tenderit dhe legjislacionit përkatës të prokurimit publik, e cila kjo oferte nuk kalon as fazen e vleresimit dhe te trajohet si e **PAPERGJEGJSHME.**

Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [operatorin ekonomik që paraqitet] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	EURO CONSTRUCTION SH.P.K.
Adresa e plotë:	Rahovec
I përfaqësuar nga:	
Emri:	Bislim Morina
Pozita:	Pronar
Nënshkrimi:	
Data:	27/04/2026
Vula:	

Pretendimi 5

Ne dosje te tenderit tek Kerkesa 2,Lista e Stafit pika c eshte kerkuar: **Min nje Arkitek bachelor apo master min 3 vite pervoje pune pas diplomit i certifikuar me licence A ose B nga MMPHI**

Gjatë vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga Grupi I operatori ekonomik 3A Projekt SH.P.K.; EURO CONSTRUCTION NNP SH.P.K., është konstatuar se për pozitën e Arkitektit është propozuar z. Dritë Qadraku. Megjithatë, nga dokumentacioni i dorëzuar **nuk është dëshmuar posedimi i Licencës A ose B të lëshuar nga MMPHI**, e cila ka qenë kërkesë e qartë dhe e detyrueshme e dosjes së tenderit.

Meqenëse licenca profesionale A ose B përbën kusht kualifikues të përcaktuar në dosjen e tenderit dhe është kërkuar shprehimisht nga autoriteti kontraktues, mungesa e saj nënkupton se kandidati i paraqitur nuk i plotëson kriteret minimale të kërkuara për këtë pozitë.

Për rrjedhojë, operatori ekonomik nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen e kërkesës së përcaktuar në Kërkesën 2 – Lista e Stafit, pika c), dhe si i tillë konsiderohet se **nuk e plotëson këtë kriter të kualifikimit profesional.**

- PRETENDIMET PER GRUPIN E OPERATOREVE EKONOMIK ARCHI TIME GROUP SH.P.K. & AXIOM ENGINEERING SH.P.K.

Pretendimi 1 :

Ne dosje te tenderit eshte kerkuar te kerkesa nr 2 pika i) **Min 5 Punetor**

Në Dosjen e Tenderit, në kuadër të kërkesave për kapacitetin profesional dhe teknik, është kërkuar që operatori ekonomik të dëshmojë se disponon minimum pesë (5) punëtorë të angazhuar për realizimin e kontratës. Kjo kërkesë është vendosur me qëllim të sigurimit se operatori ekonomik posedon kapacitetet e nevojshme njerëzore për realizimin e suksesshëm dhe brenda afateve të kontratës.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik, është konstatuar se i njëjti ka paraqitur dëshmi **vetëm për katër (4) punëtorë**, duke mos arritur të dëshmojë përmbushjen e kërkesës minimale të përcaktuar në Dosjen e Tenderit. Rrjedhimisht, operatori ekonomik nuk ka dëshmuar kapacitetin minimal teknik dhe profesional të kërkuar nga autoriteti kontraktues.

Duke qenë se kërkesa për minimum pesë (5) punëtorë përbën një kriter të detyrueshëm të kualifikimit, mosplotësimi i saj konsiderohet mangësi thelbësore dhe nuk mund të trajtohet si gabim formal apo administrativ. Për këtë arsye, operatori ekonomik nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe nuk mund të konsiderohet i përgjegjshëm për ekzekutimin e kontratës.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit kane qene dashur te konstanton se oferta e operatorit ekonomik nuk i plotëson kërkesat minimale të Dosjes së Tenderit dhe rekomandon që oferta të shpallet i papërgjegjshme, pasi operatori ekonomik nuk ka dëshmuar numrin minimal të punëtorëve të kërkuar, respektivisht ka paraqitur dëshmi për vetëm katër (4) punëtorë në vend të minimum pesë (5) punëtorëve të kërkuar

LISTA E STAFIT TE PUNËTORËVE PËR PROJEKTIN "Renovimi i objektit te shkollës Vellezërit Frashëri në Lipjan" ME NR. PROKURIMIT: 613-26-1500-5-2-1

Më:27.04.2026

Nr	Emri dhe Mbiemri	Profesioni/Pozita	Eksperiencia
1	ADEM NRECAJ	Hidroinstalues	32
2	AGRON MORINA	Teknik I Eletrotrenikes I certifikuar	20
3	KUSHTRIM KRIVAQA	Fasader	6
4	AMARILDO ABAZI	I certifikuar per punime me knauf	3
5	MENTOR DERVODELI	I certifikuar per fasade ventiluese	3
6	FATON MALIQI	Punëtor Fizik	15
7	FATOS MALIQI	Punetor Fizik	12
8	YLLNOR NRECAJ	Punetor Fizik	8
9	SELAMI MALIQI	Punetor Fizik	31

"ARCHI TIME GROUP" SH.P.K



Pretendimi 2:

Ne dosje te tenderit tek Kerkesa 3 Lista e paisjeve, me nr e eshte kerkuar: e) Makine per shpime horizontale nen rruge.

Grupi i OE ARCHI TIME GROUP SH.P.K. & AXIOM ENGINEERING SH.P.K, nuk ka prezantuar asnje makineri te tille, Për shkak të mungesës së kësaj makinerie dhe mosparaqitjes së dëshmive përkatëse, operatori ekonomik nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen e plotë të kërkesave të kapacitetit teknik të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues. Mosplotësimi i kësaj kërkesë përbën mospërmbushje të një kriteri të detyrueshëm të kualifikimit dhe ndikon drejtpërdrejt në aftësinë e operatorit ekonomik për realizimin e kontratës.

Kjo oferte duhet te konsiderohet e papergjegjshme.

Pretendimi 3: Ne dosje te tenderit tek Kerkesa 3 Lista e paisjeve, me nr j eshte kerkuar: j) Kamion kiper me vinq, hapja e vinqit min 20 m.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik, është konstatuar se i njëjti nuk ka paraqitur fare dëshmi për këtë pajisje, respektivisht nuk ka prezantuar Kamion kiper me vinq me hapje minimale 20 metra, as dokumente që dëshmojnë posedimin, marrjen me qira apo vënien në dispozicion të saj.

Meqenëse kjo pajisje është kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit si pjesë e kapaciteteve minimale teknike, mungesa e saj përbën mospërmbushje të një kërkesë thelbësore të tenderit. Për pasojë, operatori ekonomik nuk ka arritur të dëshmojë kapacitetin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues.

Kjo oferte duhet te konsiderohet e papergjegjshme.

- **PRETENDIMET PER GRUPIN E OPERATOREVE EKONOMIK NNP CTA SHPK&HAJRUSH J. SHOSHI B.I-UNIKU**
- Grupi i Operatoreve ekonomik NNP CTA SHPK&HAJRUSH J. SHOSHI B.I-UNIKU I trajtuar si i pasuksesshem nuk ploteson kerkesat minimale te dosjes se tenderit

Marrëveshja e Konsorciumit nuk i përmbush kërkesat e dosjes së tenderit dhe formularit standard të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues, pasi në të mungon elementi thelbësor që përcakton përgjegjësitë e secilit anëtar të grupit të operatorëve ekonomikë.

Shiko se ne dosje te tenderit ANEKSI 8 *DEKLARATA PER THEMELIM TE GRUPIT*

SE CFAR ESHTË KERKUAR NE DOSJE TE TENDERIT :

- Në bazë të nenit 26.15, të ndryshim plotësimin të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Operatorët Ekonomik që marrin pjesë si grup, së bashku me ofertën e tyre duhet të ofrojnë një **Marrëveshje (deklaratë) për themelimin e grupit**, në të cilën anëtarët e grupit do t'i përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë, si dhe të gjitha veprimet procedurale që duhet t'i kryej lideri i grupit në emër të grupit.

Plotësimi i Marrëveshjes (deklaratës) për themelimin e grupit, i vendosur në Aneksin 8 është obligative për Operatorët Ekonomik që marrin pjesë si grup.

- **Shiko marrveshjen e konzerciumit te prezantuar nga NNP CTA SHPK&HAJRUSH J. SHOSHI B.I-UNIKU**

Anëtarët e grupit lidhim këtë marrëveshje me të cilën deklarojmë:

- a. **Ne të gjithë anëtarët e grupit jemi bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës.**
- b. **Ne të gjithë anëtarët e grupit** konfirmojmë pjesëmarrjen tonë në grup dhe se nuk jemi duke marrë pjesë në mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit:
- c. **Ne të gjithë anëtarët e grupit e** autorizojmë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe është: [Shëno emrin e liderit të grupit]
- d. **Ne të gjithë anëtarët e grupit** konfirmojmë se **jemi të përshtatshëm** dhe do të sigurojmë dëshminë mbi përshtatshmërinë, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të FDT-së.
- e. **Ne të gjithë anëtarët e grupit** konfirmojmë pjesëmarrjen tonë në grup dhe deklarojmë se % (përqindjen) e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës është:
- a) [90 % (përqindjen) e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës së Liderit]
- b) [10 % (përqindjen) e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës së anëtarit]
- Shto sipas nevojës
- f. **Ne të gjithë anëtarët e grupit** konfirmojmë përgjegjësitë e secilit anëtar:
- a) [Shëno përgjegjësitë e Liderit] ZIJA MORINA
- b) [Shëno përgjegjësitë e anëtarit] HAJRUSH SHOSHI
- Shto sipas nevojës

Konkretisht, në marrëveshje të konzorciumit MUNGON DEKLARA E LIDERIT- emri i liderit se kush është LIDER në këto Aktivitete të prokurimit në pike nuk janë të specifikuar përgjegjësitë dhe obligimet që do të realizohen nga **lideri i grupit** dhe nga anëtarët e tjerë të konsorciumit, përkundër faktit se kjo kërkesë është paraparë shprehimisht **në formularin e marrëveshjes së konsorciumit.**

Mungesa e këtij informacioni e bën të pamundur identifikimin e rolit, pjesëmarrjes dhe përgjegjësiave kontraktuale të secilit anëtar në ekzekutimin e kontratës.

Kjo mungesë nuk paraqet një lëshim formal apo teknik që mund të korrigjohet por paraqet mungesë të një elementi esencial të marrëveshjes së konsorciumit, i cili është dashur të ekzistojë dhe të jetë pjesë e ofertës në momentin e dorëzimit të saj.

Për rrjedhojë, oferta e operatorit ekonomik nuk është në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit

dhe si e tillë është dashur të shpallet e papërgjegjshme, ndërsa pranimi i saj nga Autoriteti Kontraktues paraqet shkelje të parimit të trajtimit të barabartë dhe të kërkesave të dokumentacionit të tenderit, konkretisht Nenit 59 të LPP-se.

Per rastin e njejt kemi arsyetimin e Udhëzues 002 2024 për plotësim ndryshim të Udhëzuesit 001 2023 për prokurimin Publik

Mungon deklarata e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
Mungon deklarata e nënshkruar nga secili anëtar për konfirmim të pjesëmarrjes	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
Mungon deklarata nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit për autorizim të partnerit udhëheqës	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ

- Ne kete rast Udhëzues 002 2024 për plotësim ndryshim të Udhëzuesit 001 2023 për prokurimin Publik, tregon qarte se oferta NNP CTA SHPK&HAJRUSH J. SHOSHI B.I-UNIKU ka qene dasht te refuzohet menjehere sepse Mungon qarte se cilat jane pergjegjesit e antarve si dhe mungon deklarata per udheheqes te grupit pasi qe nuk dihet ne kete rast kush eshte udheheqes i grupit.

Autoriteti Kontraktues në mënyrë të qartë pranon se në Marrëveshjen e Konsorciumit mungon deklarimi i liderit të grupit, respektivisht mungon emri i liderit, mirëpo pavarësisht këtij konstatimi arrin në përfundimin se bëhet fjalë vetëm për një gabim teknik. Një arsyetim i tillë është kontradiktor, pasi vetë AK konfirmon mungesën e një elementi që ka të bëjë drejtpërdrejt me organizimin, përfaqësimin dhe përgjegjësinë e grupit të operatorëve ekonomikë.

Pretendimi i AK-së se lideri mund të kuptohet nga pjesë të tjera të marrëveshjes nuk mund ta zëvendësojë kërkesën për deklarim të qartë dhe të shprehur të liderit në marrëveshjen e konsorciumit. Vlerësimi i dokumenteve të ofertës duhet të bazohet në përmbajtjen e tyre të qartë dhe jo në interpretime, supozime apo deduksione tjera. Për më tepër, nëse lideri i grupit duhet të identifikohet duke interpretuar pjesë të ndryshme të dokumentit, kjo vetvetiu dëshmon se dokumenti nuk është përpiluar në mënyrën e kërkuar dhe nuk përmbush plotësisht kërkesat e dosjes së tenderit.

Veçanërisht shqetësues është fakti se Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar standard të njëjtë të vlerësimit për operatorët ekonomikë. Nga vendimi për kërkesën për rishqyrtim rezulton se për operatorë të tjerë ekonomikë ka mangësi të ngjashme në marrëveshjen e konsorciumit janë konsideruar si mangësi relevante, ndërsa për GOE NNP CTA SH.P.K. e njëjta mangësi është cilësuar si gabim teknik.

Kjo përbën trajtim të pabarabartë të operatorëve ekonomikë dhe cenim të drejtpërdrejtë të parimeve të barazisë, transparencës dhe mosdiskriminimit, të cilat janë parime bazë të sistemit të prokurimit publik.

Autoriteti Kontraktues ka cituar se :

- "Marrëveshjes i mungon deklarata e liderit, respektivisht emri i liderit."
- Pra e pranon që mungesa ekziston.
- Pastaj thotë se "në disa vende të tjera kuptohet kush është lideri".
- Dhe në fund konkludon se kjo është vetëm "gabim teknik".

Problemi këtu është se AK nuk mund ta zëvendësojë një kërkesë të qartë të marrëveshjes me interpretime ose supozime të veta. Nëse dokumenti kërkon që lideri të përcaktohet shprehimisht në marrëveshje, atëherë mungesa e këtij elementi nuk mund të korrigjohet duke lexuar pjesë të tjera të dokumentit dhe duke nxjerrë përfundime.

Vetë Autoriteti Kontraktues në arsyetimin e tij pranon se Marrëveshjes së Konsorciumit të Grupit të Operatorëve Ekonomikë NNP CTA SH.P.K. i mungon deklarata për liderin, respektivisht emri i liderit të grupit. Pra, ekzistenca e mangësisë nuk është kontestuese dhe është pranuar nga vetë AK.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim objektiv dhe ligjor se përse e njëjta mangësi prodhon pasoja të ndryshme juridike për operatorë të ndryshëm ekonomikë. Një qasje e tillë paraqet standard të dyfishtë në vlerësimin e ofertave dhe e bën vendimin e AK-së arbitrar dhe të pambështetur në parimet e trajtimit të barabartë.

Për rrjedhojë, kërkojmë nga OSHP që ta vlerësojë këtë kundërthënie të Autoritetit Kontraktues, të konstatojë se vlerësimi i ofertave nuk është bërë në mënyrë të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë dhe të anulojë vendimin e kontestuar, duke urdhëruar rivlerësimin e ofertave në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe parimet themelore të prokurimit publik.

- **DUKE U BAZUAR NE PROVAT, ARGUMENTET DESHMITE SI DHE SQARIMET E MESIPERME KERKOJME NGA OSHP , QE TE MERR NJE :**

VENDIM

- **APROVOHET** si e bazuar ankesa OE NOI CONSTRUCTION SHPK.
- **ANULOHET** Njoftimi dhe Vendimi i AK ne lidhje me kete aktivitet te prokurimit dhe lënda të kthehet ne **RIVLERSIM,**
-
- **TE DETYROHET** autoriteti kontraktues qe gjate rivlerësimit, ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i ofertave te behet ne harmoni me kerkesat e dosjes se tenderit, dhe konform dispozitave ligjore të LPP-së

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet financiare ne rast se vendimi nuk korigjohet janë jashtëzakonisht të mëdha por dëmtimi me i madh i bëhet konkurrencës se ndershme dhe te drejtë.

Neve si kompani, eliminimi nga ky aktiviteti i prokurimit na ka shkaktuar dëme si në aspektin financiar poashtu duke demtuar edhe thellësisht imazhin e kompanisë.

Vlera financiare e humbjes, fitimi I parashikuar.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura:

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. Njoftimi per kontrate 23.05.2026
2. Procesverbali i Hapjes se ofertave 27.04.2026
3. Njoftim mbi Vendimin e AK-se 05.06.2026
4. Kerkese per Rishqyrtim me daten 10.06.2026
5. Njoftimi mbi vendimin e Kerkeses per Rishqyrtim 15.06.2026

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*